

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar
Advanced Financial Reporting

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
23.09.2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	30	
2. Problemi 2	10	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

John sh.a., Maynard sh.a., dhe Keynes sh.a., janë shoqëri aksionare, të cilat operojnë në industrinë e prodhimit. Maynard sh.a., dhe Keynes sh.a., prodhojnë disa komponentë specific të cilat përdoren prej John sh.a., në procesin e prodhimit. Në të kaluarën John sh.a. ka pasur disa probleme me furnizim me mallra nga kompanitë e përmendura më sipër. Për të siguruar furnizim pa pengesa të këtyre komponenteve nga Maynard sh.a. dhe Keynes sh.a., drejtorët e John sh.a. vendosen të marrin kontroll të menaxhimit të Maynard sh.a. Andaj, John sh.a., bleu 80% të aksioneve në Maynard sh.a. me 1 korrik, 2016, duke paguar €40 për aksion në para, e cila është regjistruara në pasqyrat financiare të John sh.a. Përveq kësaj shume edhe €4.48 milion të tjera është dashur të paguhen me 30 qershor 2018. Nuk është bërë ndonjë regjistrim kontabël për konsideratën e shtyrë. Kosto e kapitalit të John sh.a. është 12%. Për të njejtën arsye, me 1 janar 2017 John sh.a. bleu 30% të aksioneve të ekuitetit në Keynes sh.a. për €12 milion në para. Pasqyrat e përmbledhura financiare të kompanive për vitin deri me 30 qershor 2017 janë si në vijim:

	Pasqyra e pozitës financiare		
	John sh.a.	Maynard sh.a.	Keynes sh.a.
	€000	€000	€000
Pasuritë			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	52,800	33,000	36,000
Pasuritë e paprekshme	7,100		
Investimet - Maynard sh.a.	38,400		
- Keynes sh.a.	<u>12,000</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
	110,300	33,000	36,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	10,150	8,900	11,400
Të arkëtueshmet tregtare	7,900	4,800	3,900
Paraja dhe banka	<u>5,925</u>	<u>2,100</u>	<u>1,700</u>
Total pasuritë	134,275	48,800	53,000
Ekuiteti			
Kapitali aksionar i zakonshëm (€10 çdo aksion)	70,000	12,000	15,000
Fitimet e mbajtura	<u>37,675</u>	<u>20,300</u>	<u>34,000</u>
	107,675	32,300	49,000
Detyrimet			
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Tatimi i shtyrë	13,800	9,800	1,750
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>			
Të pagueshmet tregtare	<u>12,800</u>	<u>6,700</u>	<u>2,250</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	134,275	48,800	53,000

Pasqyra e fitimit ose humbjes

	John sh.a.	Maynard sh.a.	Keynes sh.a
	€000	€000	€000
Të hyrat	250,000	175,000	90,000
Kosto e shitjes	<u>(185,525)</u>	<u>(128,750)</u>	<u>(69,200)</u>
Fitimi bruto	64,475	46,250	20,800
Shpenzimet e marketingut dhe shpërndarjes	(30,375)	(21,875)	(11,250)
Shpenzimet administrative	(16,750)	(11,725)	(6,030)
Kostot financiare	<u>(1,200)</u>	<u>(900)</u>	<u>(650)</u>
Fitimi para tatimit	16,150	11,750	2,870
Income tax	<u>(4,975)</u>	<u>(3,250)</u>	<u>(670)</u>
Fitimi pas tatimit	11,175	8,500	2,200

Informata shtesë:

- (i) Kur John sh.a. bleu aksionet e Maynard sh.a. vlera e pasurive jo-qarkulluese e Maynard sh.a. ishte rivlerësuar. Vlerësuesi konkludoi që prona, fabrika dhe pajset kishin vlerë të drejtë prej €5 milion mbi vlerën e tyre bartëse me jetë të mbetur të përdorimit prej pesë viteve. Maynard sh.a. përdor metodën drejtvizore për zhvlerësimin e pasurive jo-qarkulluese të prekshme. Supozo që nuk kishte vlerë të mbetur.
- (ii) John sh.a. zgjodhi të blejë shumicën e interesit në Maynard sh.a. pasi që Maynard sh.a., kishte reputacion të mirë në treg dhe kishte bazë të mirë të klientëve. Në blerje, kjo bazë e klientëve është vlerësuar në €6 milion dhe duhet të amortizohet përgjatë pesë viteve të ardhshme nga data e blerjes. Në kohën e blerjes, Maynard sh.a. gjithashtu kishte shumë emra të markave. Pasi që këto emra të markave nuk ishin blerë jashtë kompanisë, Maynard sh.a. nuk i kishte regjistruara në pasqyrat financiare. Këto emra të markave janë vlerësuar për €5 milion në datën e blerjes. Ky fakt është marrë gjithashtu në konsideratë kur negociatat për blerje ishin duke ndodhur. Është politikë e grupit t'i amortizoj emrat e markave përgjatë 10 viteve. Amortizimi i pasurive të paprekshme të mësipërme duhet t'i ngarkohet shpenzimeve të marketingut dhe shpërndarjes.

(iii) Gjatë vitit aktual, Maynard sh.a. dhe Keynes sh.a. shiten mallra tek John sh.a. si në vijim:

Shitja nga	Shitjet	Marzha mbi kosto	Pjesa e shitjeve ende në stoqe
Maynard sh.a.	€25 milion	25%	€10 milion
Keynes sh.a.	€10 milion	25%	€2.5 milion

Gjatë periudhës së njejtë, John sh.a. gjithashtu shiti mallra tek Maynard sh.a. prej €30 milion. John sh.a. aplikon një normë të fitimit prej 20% në çmimin shitës. Në fund të vitit të përfunduar me 30 qershor 2017 stoqet e Maynard sh.a. përfshinin mallrat ë pashitur në vlerë prej €12 milion (që i kushtuan Maynard sh.a.)

(iv) Llogaritë qarkulluese të grupit me 30 qershor 2017 treguan saldo prej €2.5 milion që ishte borxh i Maynard sh.a. ndaj John sh.a.

(v) Grupi John vlerëson interesin jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë në datën e blerjes, i cili është vlerësuar me €35 për aksion.

(vi) Testi i dëmtimi është kryer me 30 qershor 2017 sipas të cilit u konkludua që zëri i mirë në konsolidim i Maynard sh.a. është dëmtuar për €3 milion. Për më teper, për shkak të rënies në fitime, vlera e investimeve në Keynes sh.a. ishte dëmtuar gjithashtu për €0.5 milion.

(vii) Nuk është paguar ndonjë dividend nga ndonjëra prej këtyre kompanive gjatë vitit.

(viii) Supozo që të gjitha të hyrat dhe shpenzimet kanë ndodhur njëtrajtësiht përgjatë vitit.

(ix) Faktori is skontimit me 12%

1 vit = 0.893

2 vite = 0.797

3 vite = 0.712

Kërkohet:

Përgaditi pasqyrat financiare të mëposhtme të grupit John:

(i) Pasqyrën e konsoliduar e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 qershor 2017. (15 pikë)

(ii) Pasqyrën e konsoliduar e pozitës financiare me 31 qershor 2017. (15 pikë)

(30 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Grupi John

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 qershor 2017

	€ '000
Të hyrat (250,000 + 175,000 - 30,000 - 25,000)	370,000
KSH (185,525 + 128,750 - 30,000 - 25,000 + 1,000 + 2,400 + 2,000)	<u>(264,675)</u>
Fitimi bruto	105,325
Marketing dhe shpërndarje (30,375 + 21,875 + 1,200 + 500)	(53,950)
Shpenzimet administrative:	
Shpenzimet administrative (16,750 + 11,725)	(28,475)
Humbjet nga dëmtimi (3,000)	(3,000)
Pjesa e fitimit nga ortakëria {(2,200 x 6/12 x 30%) - 150 -500}	(320)
Kostot financiare (1,200 + 900 + 429)	<u>(2,529)</u>
Fitimi para tatimit	17,051
Tatimi në fitim (4,975 + 3,250)	<u>(8,225)</u>
Fitimi për vitin	8,826
Atribuar tek:	
Mbajtësit e ekuitetit të prindit	8,666
Interesit jo-kontrollue (L1 4)	160

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 qershor 2017

	€ '000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (52,800 + 33,000 + 5,000 - 1,000)	89,800
Pasuritë e paprekshme {(7,100 + 6,000 - 1,200) + 5,000-500}	16,400
Zëri i mirë (L1 1)	7,571
Investimet në ortakëri (L1 7)	11,830
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet (10,150 + 8,900 - 2,400 - 150 - 2,000)	14,500
Të arkëtueshmet tregtare (7,900 + 4,800 - 2,500)	10,200
Paraja dhe banka (5,925 + 2,100)	<u>8,025</u>
	<u>32,725</u>
	158,326
<i>Ekuiteti</i>	
Kapitali aksionar i zakonshëm (10 euro çdo aksion)	70,000
Rezervat (L1 3)	35,166
Interesi jo-kontrollues (L1 4)	8,560
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Tatimi i shtyrë (13,800 + 9,800)	23,600
Konsiderata e shtyrë (3,571 + 429)	4,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet tregtare (12,800 + 6,700 - 2,500)	<u>17,000</u>
	158,326

L1 1 Llogaritja e zërit të mirë	€ '000	
Kosto e investimit (L12)	41,971	
Interesi jo-kontrollues (12,000/10) x 20% x 35	<u>8,400</u>	
	50,371	
Minus pasuritë e blera		
Kapitali aksionar i zakonshëm	12,000	
Fitimet e mbajtura	11,800	
Pasuritë e paprekshme	11,000	
Korigjimet e vlerës së drejtë	<u>5,000</u>	
	<u>(39,800)</u>	
Zëri i mirë në blerje	10,571	
Dëmtimi	<u>(3,000)</u>	
	7,571	
L1 2 Llogaritja e konsideratës së blerjes	€ '000	
Paraja e paguar (12,000/10 x 40 x 80%)	38,400	
Vlera e tanishme e konsideratës së shtyrë (4,480 x 0.797)	<u>3,571</u>	
	41,971	
L1 3 Fitimet e mbajtura të konsoliduara	€ '000	€ '000
	John	Maynard
Fitimet e mbajtura sipas pyetjes	37,675	20,300
Minus para blerjes		(11,800)
Minus zhvlerësimi shtesë		(1,000)
Minus amortizimi i pasurive të paprekshme (1,200 + 500)		(1,700)
Fitimi i porealizuar		<u>(2,000)</u>
		3,800
Fitimi i porealizuar	(2,400)	
Fitimi i porealizuar (ortakëria)	(150)	
Pjesa e fitimit të prindit @ 80% e 3,800	3,040	
Pjesa e fitimit nga ortakëria	330	
Dëmtimi i ortakërisë	(500)	
Kostot financiare në konsideraten e shtyrë (3,571 x 12%)	(429)	
Dëmtimi i zërit të mirë (3,000 x 0.8)	<u>(2,400)</u>	
	35,166	
L1 4 Llogaritja e interesit jo-kontrollues BGJ	€ '000	
VD e IJK në blerje	8,400	
Pjesa e FM pas blerjes 20% x 3,800	760	
Minus dëmtimi i zërit të mirë (3,200 x 20%)	<u>(600)</u>	
Total IJK	8,560	

L1 5	Fitimi i parealizuar	€ '000		
	<i>Shitjet nga John tek Maynard</i>			
	Shitja e stoqeve	30,000		
	Fitimi i parealizuar (12 milion x 20%)	2,400		
	<i>Shitjet nga Maynard tek John</i>			
	Shitja e stoqeve	25,000		
	Fitimi i parealizuar (10 milion x 25/125)	2,000		
	<i>Shitjet nga Keynes tek John</i>			
	Shitja e stoqeve	10,000		
	Fitimi i parealizuar (30% x 2.5 milion x 25/125)	150		
L1 6	Llogaritja e interesit jo-kontrollues PA	€ '000		
	Fitimi i vitit	8,500		
	Minus: Zhvlerësimi	(1,000)		
	Amortizimi	(1,700)		
	Dëmtimi i zërit të mirë	(3,000)		
	Fitimi i parealizuar (2,000 x 20%)	<u>(2,000)</u>		
		800		
	Pjesa e IJK 20% x 800	160		
L1 7	Vlera bartëse e Keynes sh.a (ortakëri)	€ '000		
	Konsiderata në para	12,000		
	Pjesa e FM pas blerjes (2,200/12 x 6 x 30%)	330		
	Minus dëmtimi	<u>(500)</u>		
		11,830		
L1 8	Korrigjimi i vlerës së drejtë	€ '000	€ '000	€ '000
		Në blerje	Levizjet	Në datën e PPF
	Fabrika	5,000	(1,000)	4,000
	Klientët	6,000	(1,200)	4,800
	Brendi	<u>5,000</u>	<u>(500)</u>	<u>4,500</u>
		16,000	(2,700)	13,300

Problemi 2

Sharpe sh.a emetoi 50,000 obligacione të konvertueshme me vlerë nominale për obligacion prej €1,000 me 1 korrik, 2017. Obligacionet kanë maturitet tre vjeçar. Norma e kuponit është 12%, e pagueshme me 30 qershor çdo vit. Obligacionet ri-paguhen në vlerën e tyre nominale me 30 qershor 2020. Kushtet e konvertimit janë 25 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej €10 për çdo obligacion. Norma e interesit e tregut për obligacione të ngjajshme të pakonvertueshme është 14%. Supozo që të gjithë mbajtësit e obligacioneve zgjedhin opcionin e konvertimit të plotë. Supozo që nuk ka kosto të emetimit.

Faktorët e skontimit janë:

	12%		14%	
	Një shume e vetme	Anuitet	Një shume e vetme	Anuitet
Viti 1	0.8929	0.8929	0.8772	0.8772
Viti 2	0.7972	1.1601	0.7695	1.6467
Viti 3	0.7118	2.4018	0.6750	2.3216

Kërkohet:

Trego se si i obligacioni i mësipërm i konvertueshëm do të paraqitet në Pasqyrën e Pozitës Financiare të Sharpe sh.a. me 30 qershor të viteve 2018, 2019 dhe 2020. (10 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

Obligacionet	50,000
Vlera nominale	€ 1,000
Norma e kuponit	12 %
Kohëzgjatja	3 vite
Norma e tregut	14 %
Vlera	€ 50,000,000
Interesi vjetor	€ 6,000,000

Vlera e tanishme e kryegjësë	€ 50,000,000 × 0.6750 = 33,750,000
Vlera e tanishme e interesit	€ 6,000,000 × 2.3216 = <u>13,929,600</u>
	47,679,600
Vlera nominale	50,000,000
Komponenta e ekuitetit	2,320,400

Komponenta e detyrimit

		14%		
30 qershor 2018	47,679,600	6,675,144	6,000,000	48,354,744
30 qershor 2019	48,354,744	6,769,664	6,000,000	49,124,408
30 qershor 2020	49,124,408	6,877,417	6,000,000	50,001,825*

*(per shkak te rrumbullakesimit)

Pozita financiare

	30 qershor 2018	30 qershor 2019	30 qershor 2020
Ekuitet	2,320,400	2,320,400	2,320,400
Detyrim	48,354,744	49,124,408	50,001,825*

30 qershor 2020

Komponenta e detyrimit	50,000,000	
Komponenta e ekuitetit	<u>2,320,400</u>	
		52,320,400
Ekuiteti i shtuar	52,320,400	
Kapitali aksionar		12,500,000
Premia		39,820,400

Problemi 3

(a) Listo pragjet kuantitative që kërkojnë nga një entitet të raportoj ndarazi informatat për një segment operativ sipas SNRF 5 *Segmentet Operative*. (5 pikë)

(b) Ricardo sh.a ka kapital të paguar prej €60 milion që përbëhet nga 6,000,000 aksione me vlerë nominale €10 secila. Kompania ka financuar operacionet e saj duke emetuar instrumentet financiare me 1 korrik, 2016:

- (i) obligacione të konvertueshme prej € 2,000,000 me 12% me vlerë nominale prej €10 secila, të konvertueshme pas 2 viteve për 3 aksione për secilin obligacion.
- (ii) obligacione të konvertueshme prej € 4,000,000 me 10% me vlerë nominale prej €10 secila, të konvertueshme pas 3 viteve për 4 aksione për secilin obligacion.

Fitimi para tatimit i Ricardo sh.a për vitin e përfunduar me 30 qershor 2017 ishte €2,150,000. Norma e tatimit në fitim është 30%.

Kërkohet:

- (i) Llogarite fitimin e thjeshtë për aksion. (3 pikë)**
- (ii) Cili nga obligacionet e mësipërme është tretës? (6 pikë)**
- (iii) Llogarite fitimin e tretur për aksion. (6 pikë)**

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

a) Një entitet duhet të raportoj ndarazi informatat për një segment operativ që i përmbush ndonjërin nga pragjet kuantitative në vijim:

- Të hyrat e saj të raportuara duke përfshirë shitjet ndaj klientëve të jashtëm dhe shitjet apo transferet brenda segmenteve janë 10% apo më shumë të të hyrave të agreguara, të brendshme dhe të jashtme, të të gjitha segmenteve operative.
- Shuma absolute e fitimit apo humbjes së raportuar është 10% apo më shumë, në shumë absolute, e
 - fitimit të agreguar të raportuar të të gjithë segmenteve që nuk kanë raportuar humbje dhe
 - humbjen e agreguar të raportuar të të gjithë segmenteve që kanë raportuar humbje.
- Pasuritë e saj janë 10% apo më shumë të pasurive të agreguara të të gjithë segmenteve operative
- Segmentet operative që nuk përmbushin ndonjërin prej kritereve të mësipërme mund të konsiderohen të raportueshme, dhe të shpalosen ndarazi, nëse menaxhmenti beson që informatat për segmentin do të ishin të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare.

b)

i)

FPA e thjeshtë

Fitimi para tatimit	2,150,000
Tatimi me 30%	645,000
Fitimi pas tatimit	1,505,000
Nr i aksioneve	6,000,000

$$\text{FPA} = 1,505,000 / 6,000,000 = 0.25$$

ii)

Obligacionet me 12%

Aksionet shtese	$2,000,000 \times 3/10$	= 600,000
Fitimi shtese	$2,000,000 \times 0.12 \times 0.7$	= 168,000
FPA shtese	$168,000 / 600,000$	= 0.28

Obligacionet me 10%

Aksionet shtese	$4,000,000 \times 4/10$	= 1,600,000
Fitimi shtese	$4,000,000 \times 0.10 \times 0.7$	= 280,000
FPA shtese	$280,000 / 1,600,000$	= 0.175

Obligacioni me 10% është tretes

iii) FPA e tretur = $(1,505,000 + 280,000) / (6,000,000 + 1,600,000) = 0.2349$

Problemi 4

a) Friedman sh.a emetoi 300 kontrata me mundësi zgjedhjeje të aksioneve për secilin punëtor të saj të shitjes. Kjo skemë kërkonte arritjen e objektivave të planit tre vjeçar të shitjes duke filluar nga 1 janar 2016. Departamenti i shitjes përbëhej nga 100 punonjës prej të cilëve 10 punonjës lanë punën në kompani gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2016. Është vlerësuar që rreth edhe 15 punonjës të tjerë nga total fuqia punëtore e shitjes do të lënë punën në kompani deri më 31 dhjetor 2018.

Çmimi i tregut për secilën kontratë me mundësi zgjedhjeje ishte si në vijim:

Data	€
1 janar 2016	15
31 dhjetor 2016	18

Kërkohet:

Tregoni hyrjet në ditar të transaksionve mësipër dhe trego se si do të paraqiten në pasqyrat financiare të Friedman sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016. (6 pikë)

b) Në nëntor 2016, Modigliani sh.a vendosi të shës një nga zyret e saj dhe të zhvendosë stafin një zonë të industrializuar. Çmimi i zyrës ishte caktuar në €40 milion nga menaxhmenti por vlerësuesit e vlerësuan për € 35 milion duke u bazuar në çmimin e saj te tregut. Për më tepër, kompania do të vazhdonte ta përdorte zyrën derisa të ndërtohej ndërtesa tjetër e cila pritej të përfundoj në qërshor 2017.

Kërkohet:

i) **Trego se a duhet apo jo të klasifikohet zyra si ‘e mbajtur për shitje’ në pasqyrën e pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016?. Trego edhe arsyet pse.**

(2 pikë)

ii) **Shkurtimisht shpjego çfarë nënkuptoni me ‘shitja duhet të jetë shumë e mundshme’ që është një prej kriterëve që pasuritë të klasifikohen ‘si të mbajtura për shitje’, sa i përket SNRF 5 Pasuritë Jo-qarkulluese të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet e Ndërprera.**

(4pikë)

c) Markowitz sh.a është duke planifikuar që të shesë një grup të pasurive neto nga një grup i shitjes. Pasuritë neto me 31 dhjetor, 2016 janë si në vijim:

	€ në milion
	Vlera bartëse
Zëri i mirë	20
Prona, fabrika dhe paisjet	25
Stoqet	18
Pasuritë financiare	20
Detyrimet financiare	<u>(22)</u>
	61

Informata shtesë:

- Pasuritë financiare maten sipas vlerës së drejtë me 31 dhjetor 2016 dhe një fitim prej €3 milion që ka të bëjë më pasuritë financiare tashmë është njohur në ekuitet.
- Sipas SNRF-ve të aplikueshme, vlerat e rivlerësuara të pronës, fabrikës dhe paisjeve duhet të paraqiten € 22 milion dhe stoqet € 16 milion
- Vlera e drejte minus kostot e shitjes së grupit të shitjes është € 34 milion

Kërkohet:

- Llogarit dëmtimin e secilës pasuri të grupit të shitjes se Markowitz sh.a**
(5 pikë)
- Trego se si grupi i shitjes së Markowitz sh.a duhet të llogaritet në Pasqyrën e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2016.**
(3 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

Data	Përshkrimi	Debi	Kredi
31 dhjetor 2016	Kostot e punonjësve	112,500	
	Ekuiteti (kontrata me mundësi zgjedhjeje)		112,500

$$LI - 1 \text{ Kosto e stafit} = (100-25) \times 300 \times 15 \times 1/3 = \text{€}112,500$$

Pasqyra e fitimi ose humbjës Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 (ekstrakt)

Shpenzimet operative:	€
Kosto e stafit	112,500

Pasqyra pozitës financiare Me 31 dhjetor 2016 (ekstrakt)

Ekuiteti:	€
kontrata me mundësi zgjedhjeje	112,500

b)

i) Zyra nuk do të klasifikohet si e mbajtur për shitje pasi që nuk është në dizpozicion për shitje të menjëhershme sepse derisa zyret e reja të ndërtohen punonjësit do të mbeten në zyrën ekzistuese, për më tepër çmimi i vendosur për ndërtesën është mbi vlerën e tregut dhe nuk është i arsyeshëm krahasur më çmimin e tregut. Ka pak gjasa që entiteti do ta shes zyrën për atë çmim.

ii) Që shitja të jetë shumë e mundshme kriteret në vijim duhet të plotësohen:

- Menaxhmenti duhet jetë i zotuar dhe të ketë një plan të shitjes
- Duhet të ketë një program aktiv për ta gjetur blerësin
- Pasuria duhet të ketë çmim të arsyeshëm të shitjës krahasuar më çmimin e tregut
- Shitja duhet të pritët të realizohet brenda një viti nga data e klasifikimit
- Nuk ka gjasa që plani do të ketë ndryshime të mëdha apo që plani do të tërhiqet.

c)

Në € milion	Vlera bartëse	Rivlerësimi	Dëmtimi	Vlera bartëse
Zëri i mirë	20	20	20	0
Prona, fabrika dhe paisjet	25	22	2	20
Stoqet	18	16	0	16
Pasuritë financiare	20	20	0	20
Detyrimet financiare	<u>(22)</u>	<u>(22)</u>	<u>0</u>	<u>(22)</u>
	61	56	22	34

SNRF 5 kërkon që menjëherë pas klasifikimit fillestar të grupit të shitjes të mbajtur për shitje, vlera bartëse e grupit të shitjes të matet në pajtim me SNRF të aplikueshme dhe çfardo fitimi apo humbje të trajtohet sipas atyre SNRF-ve.

Pas rimaçjes, entiteti duhet të njohë një humbje nga dëmtimi prej € 22 milion. Kjo humbje duhet të alokohet sipas SNK 36.

	në € milion
Pasqyra e Pozitës Financiare	
Pasuritë qarkulluese	
Pasuritë jo-qarkulluese dhe qarkulluese	
të klasifikuara të mbajtura për shitje	56
Ekuiteti:	
Shuma e njohur direkt në ekuitet	
që ka të bëjë me pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje	3
Detyrimet afatshkurtëra	
Detyrimet direkt të lidhura me pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje	22

Problemi 5

Merton sh.a është një shoqëri aksionare, e listuar në bursën e Ilirisë. Kompania është duke tregtuar artikuj shtëpiake të elektronikës. Për shkak të konkurrencës shumë të lartë me të cilën Merton sh.a është duke u ballafaquar, konkurentët janë duke prodhuar artikuj të kualitetit të dobët dhe duke i ofruar produktet e njejta me çmim më të lirë. Si pasojë, Merton sh.a është duke e humbur pjesëmarrjen në treg.

Merton sh.a ka publikuar rezultate e gjysem vitit me 30 qershor 2016, duke treguar rënie në fitimet neto të kompanisë dhe kompania nuk lajmëroi ndonjë dividendë të përkohshme në para për aksionarët e saj. Më pas, çmimi i aksioneve të saj ra në mënyrë të konsiderueshme. Çmimi i aksioneve ishte €52 për aksion me 31 dhjetor 2015 i cili ra në €39 për aksion më 31 dhjetor 2016.

Pasqyrat e përmbledhura financiare të kompanisë për vitet 31 dhjetor 2015 dhe 2016 janë:

Pasqyra e Pozitës financiare me 31 dhjetor		
	€ milion	
	2016	2015
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, Fabrika dhe paisjet	234	145
Investimet (shënim 1)	<u>25</u>	<u>35</u>
	259	180
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	51	66
Të arkëtueshmet tregtare	71	80
Paraja	<u>4</u>	<u>21</u>
	126	167
Total Pasuritë	385	347
Ekuiteti dhe detyrimet		
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar (€10 për aksion)	80	80
Premia e aksioneve	70	70
Firimet e mbajtura	<u>117</u>	<u>87</u>
Total ekuiteti	267	237
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Kreditë afatgjata	<u>52</u>	<u>45</u>
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	48	65
Mbitërheqja bankare	<u>18</u>	<u>-</u>
	66	65
Total detyrimet	118	110
Total ekuiteti dhe detyrimet	385	347

Pasqyra e fitimit dhe humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor

€ milion

	2016	2015
Të hyrat	730	690
Kosto e shitjes	<u>(529)</u>	<u>(486)</u>
Fitimi bruto	201	204
Shpenzimet operative (shënim 1)	<u>(149)</u>	<u>(149)</u>
Fitimi para interesit dhe tatimit	52	55
Interesi	<u>(5)</u>	<u>(3)</u>
Fitimi para tatimit	47	52
Tatimi	<u>(17)</u>	<u>(19)</u>
Fitimi për vitin	30	33

- (i) Rënia në llogarinë e investimve është për shkak të humbjeve nga dëmtimi dhe është ngarkuar tek shpenzimet operative.

Kuznets është një grup i kompanive investuese që është i interesuar të investoj në Merton sh.a. Supozo që jeni caktuar nga Grupi Kuznets si konsulent financiar dhe iu është kërkuar që të analizoni pasqyrat financiare dhe të rekomandoni lidhur me investimin duke pasur parasysh rënien në çmim e aksioneve të Merton sh.a.

Kërkohe:

- (a) Duke qënë konsulent financiare i grupit te kompanive Kuznets llogariti koeficientët në vijim për analizë të pasqyrave financiare:

- Koeficientët e kthimit dhe profitabilitetit
- Koeficientët e likuiditetit
- Koeficientët e efikasitetit
- Koeficientët e investitorve

(10 pikë)

- (b) Drafto një raport për grupin Kuznets duke i analizuar koeficientët e llogaritur më sipër dhe rekomandoji menaxhmentit të Kuznets nëse duhet apo jo Merton sh.a të mirrët në konsideratë për të investuar.

(10 pikë)

Totali 20 pikë

Zgjidhja e problemit 5

a)

FPA

$$\frac{\text{Fitimi qel taken aksionarve}}{\text{Numri i aksioneve}} \times 100$$

2016

$$\frac{30}{8} = 3.8$$

2015

$$\frac{33}{8} = 4.1$$

Koeficienti C/F

$$\frac{\text{Çmimi i aksionit}}{\text{FPA}}$$

$$\frac{39}{3.8} = 10.4$$

$$\frac{52}{4.1} = 12.6$$

Marzha e fitimit bruto

$$\frac{\text{Fitimi bruto}}{\text{Shitjet}} \times 100$$

$$\frac{201}{730} = 27.5\%$$

$$\frac{204}{690} = 29.6\%$$

Marzha e fitimit operativ

$$\frac{\text{Fitimi operativ}}{\text{Shitjet}} \times 100$$

$$\frac{52}{730} = 7.1\%$$

$$\frac{55}{690} = 8.0\%$$

Marzha e fitimit neto

$$\frac{\text{Fitimi neto}}{\text{Shitjet}} \times 100$$

$$\frac{30}{730} = 4.1\%$$

$$\frac{33}{690} = 4.8\%$$

KNKA

$$\frac{\text{FPIT}}{\text{Kapitali i angazhuar}} \times 100$$

$$\frac{52}{319} = 16.3\%$$

$$\frac{55}{282} = 19.5\%$$

Periudha e qarkullimit të stoqeve

$$\frac{\text{Stoqet}}{\text{Kosto e shitjeve}} \times 365$$

$$\frac{51}{529} \times 365 = 35 \text{ ditë}$$

$$\frac{66}{486} \times 365 = 50 \text{ ditë}$$

Periudha mesatare e pagimit

$$\frac{\text{Llogaritë e pagueshme}}{\text{Kosto e shitjeve}} \times 365$$

$$\frac{48}{529} \times 365 = 33 \text{ ditë}$$

$$\frac{65}{486} \times 365 = 49 \text{ ditë}$$

Periudha mesatare e arkëtimit

$$\frac{\text{Llogaritë e arkëtueshme}}{\text{Shitjet}} \times 365$$

$$\frac{71}{730} \times 365 = 36 \text{ ditë}$$

$$\frac{80}{730} \times 365 = 42 \text{ ditë}$$

Koeficienti qarkullues

$$\frac{\text{Pasuritë afatshkurtera}}{\text{Detyrimet afatshkurtera}}$$

$$\frac{126}{66} = 1.9$$

$$\frac{167}{65} = 2.6$$

Koeficienti i shpejtë

$$\frac{\text{Pasuritë afatshkurtera-stoqet}}{\text{Detyrimet afatshkurtera}}$$

$$\frac{126-51}{66} = 1.1$$

$$\frac{167-66}{65} = 1.6$$

Koeficienti i borxhit

$$\frac{\text{Borxh}}{\text{Ekuitet}} \times 100$$

$$\frac{70}{267} \times 100 = 26.2\%$$

$$\frac{45}{237} \times 100 = 19.0\%$$

Mbulesa e interesit

$$\frac{\text{FPIT}}{\text{Shpansimet e interesit}}$$

$$\frac{52}{5} = 10.4$$

$$\frac{55}{3} = 18.3$$

Kosto mesatare e borxheve

$$\frac{\text{Shpansimet e interesit}}{\text{Total Borxhi}} \times 100$$

$$\frac{5}{70} \times 100 = 7.1\%$$

$$\frac{3}{45} \times 100 = 6.7\%$$

b) Për: Drejtorin ekzekutiv
Kuznets Grup

Data: _____

Rishikim dhe Këshillim për Pasqyrat Financiare të Merton sh.a

I nderuar,

Çmimi i aksionve të Merton sh.a ka rënë dukshëm për shkak të rënies në fitime si dhe FPA, dhe nuk janë shpërndarë dividendë për aksionarët. Më sa duket fitimet janë zvogëluar kryesisht për shkak të dëmtimit të investimit për €10 milion i regjistruar gjatë vitit, përndryshe marzha e fitimi operativ do të ishte më e lartë në 8.5% e llogaritur si $(52+10)/730$ që nëkupton që shpenzimet operative kane qënë nën kontroll.

Investitorët janë të brengosur për të ardhmen e Merton sh.a pasi që koeficienti i Ç/F ka rënë nga 12.6 në 10.4 që nuk është e pazakontë pasi që investitorët që kërkojnë kthim në afatin e shkurtë duket të kenë qënë të dëshpëruar me rezultatin.

Fitimi bruto i Merton sha ka rënë nga 29.6% në 27.5% që mesiguri është si rezultat i presionit ndaj çmimeve nga konkurenca, rritjes në kostot e prodhimit dhe shitjes së stoqeve me çmim më të ulët për të iu shmangur vjetërsisë. Tregues pozitiv është që menaxhmenti ka reaguar shpejt ndaj presioneve të tregut për të mbetur konkurrent edhe më tej.

Kthimi në kapitalin e angazhuar ka rënë nga 19.5% në 16.3% për shkat të rënies në fitime dhe rritjes së kapitalit të angazhuar nga mbitërheqja bankare.

Marzha e fitimit neto ka rënë për 0.7 pikë përqindje. Kosto në rritje e financimit ka pasur ndikim pjesërisht edhe pse norma mesatare e interesit nuk është rritur shumë (0.4 pp). Rënia në fitim ka ndikuar në mbulimin e interesit. Mbulimi i interesit ka rënë nga 18.3 në 10.4, që është ende i mjaftueshëm për të absorbuar nëse kompania ka nevojë për financim shtesë.

Koeficienti i borxhit është rritur nga 19.0 % në 26.2% kryesisht për shkak të mbitërheqjes bankare. Mbitërheqja bankare është përdorur përkundër ripagimit të shpejtë të të arkëtueshmeve me periudhën e arkëtimit të zvogëluar nga 42 ditë në 36 ditë. Shuma e mbiterheqjes bankare mësiguri që përdoret për të paguar të pagueshmet për shkak të afatit të shkurtë nga furnitorët siç është evidentuar nga zvogëlimi i peridhës së pagesës nga 49 ditë në 33 ditë. Mbajtja e stoqeve është zvogëluar nga 50 ditë në 35 ditë dhe kjo mund të jetë rezultat i menaxhmentit që ka reaguar për t'i shitur artikujt e vjeter dhe evituar vjetërsinë e stoqeve.

Edhe pse ka një rënie në koeficientin qarkullues dhe koeficientin e shpejtë, kjo nuk është alarmuese. Merton sh.a duhet të siguroj financim afatgjatë për të investuar në pasuritë jo-qarkulluese të prekshme për të qënë konkurrent në treg.

Rekomandim:

PFPP prej €234 milion jep siguri të arsueshme, dhe me vetëm €52 milion të borxheve afatgjata me 31 dhjetor 2016. Për më tepër, mbulimi i interesit prej 10.4 është i mjaftueshëm, andaj menaxhmenti i Kuznets Grup mund të konsideroj të dy opcionet edhe të investimit në borxh edhe atë të investimit në ekuitet për të shfrytëzuar çmimin aktual të ulët të aksionit të Merton sh.a.